



**Kolegji AAB**

CILËSI. LEADERSHIP. SUKSESI!

# **Rregullore për Kalendarin e Aktiviteteve të Rregullta Vjetore**

## Përmbajtja

I.	Dispozita të përgjithshme.....	2
II.	Çështjet akademike.....	2
a.	Personeli Akademik .....	2
b.	Orari i ligjëratave .....	2
c.	Afatet e provimeve .....	3
d.	Afatet e vlerësimit të profesorëve nga studentët .....	3
e.	Afatet për aktivitetet e këshillave mësimore .....	3
III.	Çështjet teknike .....	4
IV.	Departamenti i marketingut.....	4
V.	Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar.....	5
a.	Propozimet për projekte ndërkombëtare .....	5
VI.	Aktivitetet shkencore hulumtuese .....	5
a.	Projektet hulumtuese .....	5
b.	Konferenca shkencore .....	5
VII.	Revista shkencore “Thesis”.....	6
VIII.	Përgjigjet në kërkesa .....	6
IX.	Afatet e pagesave .....	7
X.	Llogaritja e afateve.....	7
XI.	Dispozitat Kalimtare.....	7

Me qëllim të rritjes së efikasitetit të shërbimeve, Rektori i Universitetit nxjerr këtë:

**RREGULLORJA Nr. 3729/2014**  
**PËR**  
**KALENDARIN E AKTIVITETEVE TË RREGULLTA VJETORE**

**I. Dispozita të përgjithshme**

Neni 1

Përmes kësaj rregulloreje përcaktohen afate për kryerjen e detyrave të ndryshme që kanë të bëjnë me çështjet akademike, administrative, marketingut, teknike dhe shërbimeve tjera.

Neni 2

Viti akademik fillon me 1 tetor dhe përfundon me 30 shtator të vitit të ardhshëm. Mësimi organizohet në semestra dhe semestri i parë fillon në ditën e parë të punës të muajit tetor, ndërsa semestri i dytë fillon në gjysmën e dytë të shkurtit.

**II. Çështjet akademike**

**a. Personeli Akademik**

Neni 3

Propozimet nga fakultetet për angazhimin e stafit akademik për semestrin e parë dorëzohen më së largu deri më datën 30 qershor, kurse për semestrin e dytë më së largu deri më 1 nëntor.

Neni 4

Aprovimi i propozimeve të fakulteteve për angazhimin e stafit akademik bëhet nga Rektorati më së largu deri më 1 shtator për semestrin e parë dhe 15 dhjetor për semestrin e dytë.

Neni 5

Kontraktimi i profesorëve bëhet më së largu deri më 15 shtator për semestrin e parë dhe 1 shkurt për semestrin e dytë

**b. Orari i ligjëratave**

Neni 6

Dërgimi i orareve nga administrata qendrore për diskutim në dekanate bëhet më së largu deri 5 shtator për semestrin e parë dhe 30 dhjetor për semestrin e dytë.

Neni 7

Aprovimi i orareve nga rektorati bëhet më së largu deri më 10 shtator për semestrin e parë dhe 15 janar për semestrin e dytë

Neni 8

Publikimi i orareve nga administrata qendrore bëhet më së largu deri më 15 shtator për semestrin e parë dhe 5 shkurt për semestrin e dytë.

*c. Afatet e provimeve*

Neni 9

1. Shpallja e orarit për afatin e janarit bëhet më së largu deri me datën 15 dhjetor. Afati i janarit organizohet prej **20 janar deri 20 shkurt**.
2. Shpallja e orarit për afatin e prillit bëhet më së largu deri me datën 10 mars. Afati i prillit organizohet prej **01 prill deri 20 prill**.
3. Shpallja e orarit për afatin e qershorit bëhet më së largu deri me datën 15 maj. Afati i qershorit organizohet prej **10 qershor deri 30 qershor**.
4. Shpallja e orarit për afatin e shtatorit bëhet më së largu deri me datën 20 gusht. Afati i shtatorit organizohet prej **01 shtator deri 20 shtator**.
5. Shpallja e orarit për afatin e tetorit-nëntorit bëhet më së largu deri me datën 01 tetor. Afati i tetorit-nëntorit organizohet prej **15 tetor deri 5 nëntor**.

Neni 10

Dorëzimi i raportit të suksesit për afatin e provimit bëhet më së largu 2 javë pas datës së fundit të afatit përkatës.

*d. Afatet e vlerësimit të profesorëve nga studentët*

Neni 11

Vlerësimi i profesorëve nga studentët përmes e-service për semestrin e parë bëhet gjatë periudhës kohore prej 3 janar deri 20 janar, ndërsa përpunimi i rezultateve bëhet më së largu deri 30 janar dhe analizimi i raporteve dhe rekomandimet bëhen më së largu deri 15 shkurt.

Neni 12

Për semestrin e dytë, vlerësimi bëhet gjatë periudhës kohore prej 15 maj deri 10 qershor, ndërsa përpunimi i rezultateve bëhet më së largu deri 15 qershor dhe analizimi i raporteve dhe rekomandimet bëhen më së largu deri 1 korrik.

*e. Afatet për aktivitetet e këshillave mësimore*

Neni 13

Këshillat mësimorë i mbajnë tri mbledhje të rregullta brenda një viti akademik. Mbledhja e parë mbahet më së largu 7 ditë para fillimit të vitit akademik, mbledhja e dytë mbahet më së largu 7 ditë para fillimit të semestrit të dytë dhe mbledhja e tretë mbahet më së largu 3 ditë pas përfundimit dhe para fillimit të afatit të qershorit.

Neni 14

Dorëzimi i syllabuseve nga profesorët në dekanat bëhet më së largu deri 15 shtator, ndërsa verifikimi dhe rishikimi i syllabuseve nga dekanatet duhet të përfundoj brenda 10 ditëve respektivisht më së largu deri 25 shtator.

Neni 15

Prezantimi i lëndëve zgjedhore, formimi i grupeve dhe fillimi i rregullt i ligjëratave për lëndët zgjedhore bëhet më së largu deri në javën e dytë të semestrit.

Neni 16

Ushtrimet fillojnë nga java e dytë prej fillimit të ligjëratave.

### **III. Çështjet teknike**

Neni 17

Plani i furnizimit me pajisje mësimore për semestrin e parë duhet të dorëzohet më së largu deri 1 gushtë, ndërsa furnizimi duhet të përfundojë më së largu deri 1 shtator.

Neni 18

Plani i furnizimit me pajisje mësimore për semestrin e dytë duhet të dorëzohet më së largu deri 10 shkurt, ndërsa furnizimi duhet të përfundojë më së largu deri 20 shkurt.

Neni 19

Menaxheri i shërbimit teknik dorëzon raportin për gatishmërinë e pajisjeve teknike më së largu deri më 20 shtator për semestrin e parë dhe 15 shkurt për semestrin e dytë.

Neni 20

Përgatitja dhe investimet në kampusin e Universitetit duhet të përfundojnë më së largu deri më 15 gusht.

### **IV. Departamenti i marketingut**

Neni 21

Plani i marketingut dorëzohet nga zyra e marketingut në rektorat më së largu deri më 15 dhjetor dhe aprovimi bëhet brenda 10 ditëve nga data e dorëzimit.

Neni 22

Ditët e AAB-së përbëhen nga aktivitete shkencore, artistike, kulturore, humane, sportive dhe argëtuese dhe të gjitha këto organizohen brenda periudhës 10 maj deri 5 qershor.

Neni 23

Agjenda e cila përcakton aktivitet në detale e deri të shpërblimet dhe përmbyllja, përgatitet nga departamenti i marketingut më së largu deri më datën 1 maj.

## **V. Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar**

### ***a. Propozimet për projekte ndërkombëtare***

Neni 24

- Propozimet nga fakultetet për projekte bëhen më së largu deri në javën e parë të muajit maj të secilit vit akademik;
- Miratimet nga Prorektori për marrëdhënie me jashtë bëhen deri në javën e fundit të muajit maj;
- Miratimi i projekt-propozimeve nga rektorati bëhet deri në javën e tretë të qershorit;
- Hartimi i projekteve bëhet sipas afateve të fondeve vendore e ndërkombëtare;
- Raportet vjetore të implementimit bëhen në dhjetor të secilit vit.

## **VI. Aktivitetet shkencore hulumtuese**

### ***a. Projektet hulumtuese***

Neni 25

Aktivitetet shkencore hulumtuese bëhen në nivel të Fakulteteve dhe Universitetit dhe të gjitha në koordinim me zyrën për marrëdhënie me jashtë dhe për projekte dhe atë sipas kësaj procedure dhe kronologjie:

- a. Hapja e konkursit për aplikim me projekt propozime bëhet në javën e parë të muajit tetor;
- b. Shqyrtimi dhe aprovimi i projekteve bëhet në javën e parë të muajit nëntor;
- c. Monitorimi i implementimit të projekteve të miratuara nga zyra për projekte;
- d. Hartimi i raportit përfundimtar me gjetjet dhe rekomandimet e projekteve bëhet në javën e parë të prillit;
- e. Shpallja dhe publikimi i të dhënave bëhet përmes tryezave, revistës shkencore dhe konferencës shkencore në muajin shtator/tetor.

### ***b. Konferenca shkencore***

Neni 26

Konferencat shkencore organizohen nga fakultetet përkatëse në bashkëpunim me Zyrën për marrëdhënie me jashtë dhe atë sipas kësaj procedure dhe kronologjie:

- a. Hapja e konkursit për abstrakte bëhet në javën e parë të muajit tetor;
- b. Shqyrtimi dhe aprovimi i abstrakteve bëhet më së largu deri në fund të javës së parë të muajit nëntor;
- c. Shpallja e folësve kryesorë dhe vlerësimi i punimeve bëhet më së largu deri në javën e parë të prillit;
- d. Botimi i punimeve bëhet në numrin e parë të revistës (qershor);
- e. Përgatitjet për konferencë finalizohen më së largu deri në javën e parë të shtatorit;
- f. Botimi i fjalimeve kryesore të konferencës bëhet në numrin e dytë të revistës (dhjetor).

## **VII. Revista shkencore “Thesis”**

Neni 27

Revista shkencore “Thesis” publikohet dy herë në vit: në muajin qershor dhe dhjetor të vitit përkatës akademik.

Neni 28

Hapja e konkursit për punime bëhet në javën e parë të muajit janar për numrin e parë dhe në javën e parë të muajit shtator për numrin e dytë.

Neni 29

Grumbullimi i abstrakteve bëhet më së voni dy javë pas shpalljes së konkursit. Vlerësimi dhe përzgjedhja e abstrakteve më të mira bëhet më së voni tri javë pas mbylljes së konkursit. Grumbullimi i punimeve të përzgjedhura bëhet më së voni tetë javë pas mbylljes së konkursit.

Neni 30

Vlerësimi i punimeve nga komisionet recensuese bëhet brenda afatit prej dy javësh nga dita e mbylljes së grumbullimit të punimeve dhe finalizimi i punimeve nga autorët bëhet më së voni dy javë pas dorëzimit të vlerësimeve nga komisionet vlerësuese.

Neni 31

Lektura e punimeve përfundon brenda afatit prej dy javësh nga dita e dorëzimit të punimeve nga autorët/komisionet recensuese.

Neni 32

Përgatitja dhe shtypja e revistës duhet të bëhet brenda afatit të përcaktuar në nenin 27.

## **VIII. Përgjigjet në kërkesa**

Neni 33

Përgjigjet në kërkesat e studentëve, bëhen më së largu 3 ditë nga dorëzimi i kërkesës përveç nëse me Rregulloren e studimeve është paraparë ndonjë afat më i shkurtër kohor.

Neni 34

Profesorët për çdo kërkesë me shkrim i drejtohen dekanateve dhe këta të fundit obligohen që më së largu brenda 3 ditëve të kthejnë përgjigjen.

Neni 35

Dekanët dhe Menaxherët e sektorëve kërkesat e tyre i drejtojnë tek Rektori ose Zëvendësrektori të cilët obligohen që më së largu brenda 3 ditëve të kthejnë përgjigje.

Neni 36

Afati 3 ditor për përgjigje në kërkesa vlen edhe për gjithë sektorët tjerë.

## **IX. Afatet e pagesave**

Neni 37

Pagesat mujore (pagat), për stafin e rregullt bëhen më së largu deri më datën 5 të muajit për muajin e kaluar, ndërsa për stafin e angazhuar më së largu deri më datën 10 të muajit për muajin e kaluar.

## **X. Llogaritja e afateve**

Neni 38

Afatet llogariten në ditë, muaj dhe vite.

Neni 39

Nëse afati është caktuar në ditë atëherë përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën është dhënë detyra, kështu afati rrjedh nga dita e parë e ardhshme.

Neni 40

Kur dita e fundit e një afati bie në ditë feste apo ditën e diel ose në ndonjë ditë ku nuk punon Universiteti, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas pushimit.

Neni 41

Afati që është caktuar në muaj apo vite, mbaron me kalimin e ditës së fundit të muajit respektivisht të vitit që sipas numrit i përgjigjet ditës kur ka filluar afati

## **XI. Dispozitat Kalimtare**


Neni 42

Në rast se dispozitat e kësaj rregulloreje bien ndesh me dispozitat e Statutit apo Rregullores së studimeve atëherë përparësi kanë dispozitat e këtyre të fundit.

Neni 43

Kjo rregullore hynë në fuqi pas miratimit të saj nga Senati dhe nënshkrimit nga Rektori.

Dr. Lulzim Tafa, Rektor



Prishtinë 2014